



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Gridi Elezi** me datë **11.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj kërkuesit (personit nën hetim) me vendimin Nr. 54, dt. 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 237, 263/1 shkronja “b” dhe 266 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **718**, datë **13.12.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (personit nën hetim) **Gridi Elezi**.
2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale e caktuar ndaj kërkuesit (personit nën hetim) **Gridi Elezi** me vendimin Nr. 54, dt. 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të kalimit të kohëzgjatjes maksimale të afateve të masës së sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 263/1 shkronja b) të K.Pr.Penale.
3. Caktimin ndaj shtetasit **Gridi Elezi**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave*” kryer në në formën e grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*”, si dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga nenet 189/1-28/4, 333/a dhe 334/1 i Kodit Penal të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.
4. Urdhërohet personi nën hetim **Gridi Elezi** që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në ****.
5. Urdhërohet liri i menjëhershëm i personit nën hetim **Gridi Elezi** nga ambjentet e paraburgimit nëse ai nuk mbahet i arrestuar me ndonjë masë tjetër sigurimi “*Arrest në burg*” si i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale apo me ndonjë vendim dënimi me burgim.
6. Urdhërohet policia gjyqësore dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar për zbatimin e këtij vendimi.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brënda 5 ditëve, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 13.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar